

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E FINANCËVE / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE	
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY	
Nr. Org. Org. reference Org. Unit	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.
1125	71119
Data : Datum : Date :	02/05/2019
Priloge / a	



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

Agjencia Qendrore e Prokurimit-Centralna Agencia Nabavke-Central Procurement Agency

KONTRATË PËR FURNIZIME

TITULLI I KONTRATËS:

Furnizim me karburante (benzin dizell) LOT I

NUMRI I PROKURIMIT: UA/2016 18-3702-1-1-1

NUMRI I BREND SHEM AQP 18 002 111

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË¹, KUSHTET & ANEKSET E NDËRLIDHURA

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

Agjencia Qendrore e Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues i cili prokuron në emër të Autoriteteve Kontraktuese të specifikuara në Aneksin 7"), në njërën anë;

dhe

HIB PETROL SH.P.K Nr.Fiskal:600015376 Nr.i Biznesit: 70249534 (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike kornizë për **Furnizim me karburante (benzin dizell) LOT I**, me numër identifikues: **AQP/18/002/111**.

Titulli: Furnizim me karburante (benzin dizell) LOT I me numër identifikues: UA/2016-18-3702-1-1-1 dhe numër të brendshëm AQP-18-002-111

Numri rendor i kontratës: 08/19 DPQ

AQP-18-002-111 Lot I

Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej 37 muaj dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hynë në fuqi

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e Karburanteve (shih Aneksin 1 për përshkrimin e këtyre produkteve dhe sasi të parashikuar që mund të dorëzohen gjatë kohëzgjatjes së kontratës publike kornizë):

- a) Naftë për automjete në pikat e shpërndarjes (pompat e Benzinës) të përcaktuara nga Operatori Ekonomik siç specifikohet në Aneksin 9;
- b) Benzinë për automjete në pikat e shpërndarjes (pompat e Benzinës) të përcaktuara nga Operatori Ekonomik siç specifikohet në Aneksin 9;
- c) Naftë për gjenerator në pikat e shpërndarjes së Autoriteteve Kontraktuese siç specifikohet në Aneksin 7;
- d) Benzinë për gjeneratorë në pikat e shpërndarjes së Autoriteteve Kontraktuese siç specifikohet në Aneksin 7;
- e) Naftë për ngrohje në pikat e shpërndarjes së Autoriteteve Kontraktuese siç specifikohet në Aneksin 7.

Agjencia Qendrore e Prokurimit bënë blerjen në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese të specifikuara në Aneksin 7.

Përdorimi i kësaj Kontrate Publike Kornizë është obliguese për të gjitha Autoritetet Kontraktuese të specifikuara në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit.

1.2 Për furnizim me karburante për gjenerator dhe naftë për ngrohje, kjo kontratë publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Agjencia Qendrore e Prokurimit apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë karburante për gjeratore apo naftë për ngrohje në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar llojin e karburanteve për furnizim me sasi të tyre përkatëse dhe adresën e sakte se ku duhet të dërgohet karburanti.

¹⁶ Para nënshkrimit të kontratës "kjo Draft Kontratë Publike Kornizë " duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit të prokurimit

Nuk nevojitet fletëporosia apo thirrja për furnizim me karburante për vetura. Secili Autoritet Kontraktues i specifikuar në Aneksin 7, brenda 7 (shtete) ditëve, pas pranimi të kopjes së nënshkruar të kontratës nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, është i obliguar që të dorëzojë tek Operatori Ekonomik një listë të veturave (me numra të regjistrimit) të autorizuar për furnizim në pompat e benzinës së Operatorit Ekonomik. Një listë e tillë mund të freskohet kohë pas kohe nga ana e AK-ese. Një listë e tillë do të jetë efektive vetëm pas 24 orësh pas datës dhe kohës së marrjes së një liste të tillë nga ana e Operatorit Ekonomik.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurorin mallrat përmendura në 1.1. Sidoqoftë, sasitë e vlerësuara do të rishikohen edhe një herë para hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 12.07.2019 dhe përfundon në datën 11.07.2022. Sidoqoftë, në rast se sasitë e parapara në kontratën e udhëhequr përmes procedurës së negociuar pa publikim skadojnë para datës së parapare, në përputhje me nenin 56.10 të RUOPP, kontrata e udhëhequr përmes procedurës së negociuar pa publikim do të ndërpritet automatikisht dhe Agjencia Qendrore e Prokurimit do të informoj me shkrim 7 dite më parë Furnizuesin, për hyrje në fuqi të kësaj kontrate.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim të karburanteve për gjenerator dhe naftë për ngrohje është 3 (tri) ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues. Përderisa për furnizimin e karburanteve për vetura furnizuesi duhet të sigurojë që pompat e benzinës, të përcaktuara nga Furnizuesi si specifikohet në Aneksin 9, të jenë të hapura 7 ditë/24 ore.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit (karburante për gjenerator dhe naftë për ngrohje) do të jetë në adresat e specifikuar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit dhe për furnizim me karburante për vetura në pikat e shitjes së OE (pompat e benzinës) të përcaktuara në Aneksin 9.

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP²(Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

¹⁷DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi.

Ne	Lloji i karburantit	Premiumi per nje liter
1	Diesel per vetura, gjenerator, nxehe dhe mjete tjera levizese 10 ppm	
2	Benzine per vetura 10 ppm	

Vlera totale indikative e kontratës është. : **11,348.228,85 €; (Njëmbëdhjetë milion e treqind e katërdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet e tetë euro e tetëdhjetë e pesë cent)**

Devijimi i lejuar nga vlera totale indikative është [30%]. 4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Kalkulimi i cmimit gjate realizimit te kontrates behet duke u bazuar ne cmimin mesatar mujor te berzes se Plattit CIF Med (Genova/Lavera) , kursit mesatar mujor te Bankes Qendrore Evropiane dhe elementeve tjera fikse dhe variabile qe jane pasqyruar ne Aneksin 10 - Tabela per llogaritjen e cmimit kushtues te karburanteve.

4.4 Agjencia Qendrore e Prokurimit ka qasje ne berze dhe bene kalkulimin e cmimit ne baza mujore duke u bazuar ne tabelen e formimit te cmimeve. Autoriteti Kontraktues, Agjencia Qendrore e Prokurimit, me se largu deri me daten pese (5) te muajt vijuesdergon te Furnizuesi kalkulimin e cmimeve per muajin paraprak. Obligohet Furnizuesi qeme se largu deri me daten dhjete (10) te muajt vijues ti dergoje te gjitha faturat pershpensimet e karburanteve per muajin paraprak te Autoritetet Kontraktuese qeshfrytezojne kontraten te specifikuar ne Aneksin 7. Agjencia Qendrore e Prokurimit ,vendimin e formimit te cmimeve te karburanteve per cdo muaj do ta publikoj ne uebfaqen e AQP-se. Kete vendim te formimit te cmimeve te publikuar ne ueb faqen e AQPsekan te drejte ta shfrytezojne vetem Autoritetet Kontraktuese qe jane shfrytezues tekesaj kontrate kornize dhe jane te specifikuar ne Aneksin nr. 7.

4.5 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Aneksi nr. 1 - Specifikat teknike të Detyrueshme
- (g) Aneksi nr. 7 - Lista e Autoriteteve Kontraktuese
- (h) Aneksi nr. 9 - Lokacionet e Pikave të Karburantit
- (i) Aneksi nr. 10 - Tabela e formimit të cmimeve
- (j) Urdher blerja.

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet cilitdo Autoritet Kontraktues të specifikuar në Aneksin 7, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër


duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Në të gjitha këto komunikime Agjencia Qendrore e Prokurimit duhet të njoftohet (Cc-ed) në mënyrë që të përcjell zbatimin e kontratës.


6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shënohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe dhe Serbe in në tri origjinale, dy origjinale për Agjencinë Qendrore të Prokurimit dhe një origjinal për Furnizuesin. Një kopje e nënshkruar e kontratës do të dorëzohet secilit Autoritet kontraktues të specifikuar në Aneksin 7 nga Agjencia Qendrore e Prokurimit.

Për: Agjencinë Qendrore të Prokurimit

Emri:	Mursel Raci
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	02.05.2019
Vula:	

Emri:	Behxhet Rrukiqi
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data:	02.05.2019
Vula:	

Për Furnizuesin

Emri:	FATBARDH XHAFERI
Pozita:	MENAXHER I KONTRAKTIMEVE
Nënshkrimi:	
Data:	02.05.2019



Vula:	
-------	---

PJESA II E KONTRATËS

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 **"Autoriteti Kontraktues"** do të thotë cilido Autoritet Kontraktues i specifikuar ne Aneksin 7.

1.3 **"Produktet"** përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.4 **"Agjencia Qendrore e Prokurimit"** do të thotë organizata e cila konkludon aktivitetin e prokurimit ne emer te Autoriteteve te tjera Kontraktuese, sic eshte përcaktuar ne Fleten e te Dhenave.

1.5 **"Furnizues"** do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.6 **"Palë(t)"** do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.7 **"Inkotermet"** do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.8 **"Furnizim"** do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.9 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.10 **"Shërbimet pas shitjes"** do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.11 **"KPK"** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.12 **"KVK"** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta

transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Furnizuesi duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë të Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Ndhimja lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Siguria e ekzekutimit

8.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

8.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

8.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës së perkohshme të pranimit.

Neni 9 Sigurimi

9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jene të siguruara plotësisht me një valute lirisht të konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit të rastësishëm të prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj në mënyrën e specifikuar në KVK.

9.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 9.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 10 Marrëveshjet tatimore dhe doganore

10.1 Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për pagesën e të gjitha taksave, detyrimeve të pullës, taksat e licencave, tarifatat doganore dhe taksat tjera që lindin apo imponohen deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara në vendin e dorëzimit, siç është përcaktuar nga Autoriteti

Kontraktues.

Neni 11 Patentat dhe licencat

11.1 Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 12 Periudha e ekzekutimit të detyrave

12.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e lëshimit të Urdhër Blerjes, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 13.

Neni 13 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

13.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues porosit furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhëra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

13.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

13.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 14 Vonesat e ekzekutimit

14.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Furnizuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e furnizuesit.

14.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 14.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

14.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emer të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- tekonfiskojë garancinë e realizimit;

- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
 - të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.
- b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*
- tekonfiskojë garancinë e realizimit;
 - te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
 - te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.
- c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:*
- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porposine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
 - te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.
- a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
 - te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
 - te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 15 Suspendimi

15.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimi në kohën e specifikuar për dorëzim; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimi.

15.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimi në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

15.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimi;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të

saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

15.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimi të urdhrin për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

15.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkitazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

15.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

15.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbajtjesore, parregullsive ose mashtrimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtrime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimit.

15.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtjesore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përmbajtjesore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 16 Cilësia e furnizimeve

16.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

16.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

16.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 17 Inspektimi dhe testimi

17.1 Furnizues do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimi me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë.

17.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimi apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

17.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizues do të:

- a) I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për

testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;

b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;

c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

17.4 Nëse përfaqësuesi i Autoriteti Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përveç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuara si duhet të rezultateve të testit të Autoriteti kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

17.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

17.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'ia japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të furnizuesit. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohet se është gabim pas ri-testimit.

17.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimit.

Neni 18 Parimet të përgjithshme të pagesave

18.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Furnizues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

18.2 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

18.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

18.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 18.2, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

18.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

18.6 Në rast se Autoriteti Kontraktues është duke blerë në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese, dhe nëse një autoritet kontraktues nuk plotëson obligimet e tij sipas kësaj kontrate sidomos obligimet e Nenit 18.2 furnizuesi mund të informojë AQP-në për shkelje të tillë. AQP mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i ndonjë dhe i të gjitha kontratave të

përbashkëta kornizë të konkluduara nga AQP.

Neni 19 Dorëzimi

19.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

19.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit.

19.3 Paketimi, shënimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

19.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimit derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimit të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

19.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 20 Operacionet e verifikimit

20.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

20.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhrë, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjesshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtërinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;
- d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

20.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuar. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbresë nga paratë që do të paguhen ose të cilat do të bëhen obligim për t'u paguar Furnizuesit.

20.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimit, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do të refuzohen.

Neni 21 Pranimi i përkohshëm

21.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimi të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

21.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimi të përkohshëm atëherë kur furnizimet të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njëres nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimi të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kërkon Furnizuesi për ta lëshuar certifikatën.

21.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimi ose e refuzimit do të përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Furnizuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evituar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje të përshtatshme për pranim.

21.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimi të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përveç në rastet kur certifikata e pranimi të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të pranimi përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë në pjesë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për secilën pjesë.

21.5 Në raste të dorëzimit të pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pjesshëm e të përkohshëm.

21.6 Pas pranimi të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkojnë më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimi siç kërkojnë në kontratë.

Neni 22 Obligimet për garanci

22.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

22.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për menjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose
- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
- c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

22.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

22.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë

dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërpresë kontratën.

22.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 23 Shërbimet pas-shitjes

23.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 24 Pranimi përfundimtar

24.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 22 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

24.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

24.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Neni 25 Shkelja e kontratës

25.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

25.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

25.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose

b) dëme të likuidueshme.

25.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 26 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

26.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) Kur Furnizuesi në mënyrë përmbajtjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j) Të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) Shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

26.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshtkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përmbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

26.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

26.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues.

në datën e ndërprerjes së kontratës.

26.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

26.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

Neni 27 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

27.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 7 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumën që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

27.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

27.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 27.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 28 Forca madhore

28.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

28.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objekteve ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

28.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 14 dhe 26, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 18.4 dhe 27, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

28.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

28.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 28.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 29 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të

dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

29.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 30 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

30.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATËS**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Nen-kontraktimi	4	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Dhënia e dokumenteve	5	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit. Secili Autoritet Kontraktues i specifikuar në Aneksin 7, brenda 7(shtate) diteve, pas pranimit të kopjes së nënshkruar të kontratës nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, është i obliguar që të dorëzojë tek Furnizuesi një listë të veturave (me numra teregjistrimit) të autorizuar për furnizim në pompat e benzines Operatorit Ekonomik. Një listë e tillë mund të freskohet kohë pas kohe nga ana e AK-së. Një listë e tillë do të jetë efektive për Furnizuesin vetëm pas 24 orësh pas datës dhe kohës së pranimit të një listë të tillë nga Autoriteti Kontraktues. Çdo Autoritet Kontraktues i specifikuar në Aneksin 7, brenda 5(pese) diteve, pas pranimit të kopjes së nënshkruar të kontratës nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, është i obliguar që të hartojë Planin e Menaxhimit të Kontrates Çdo Autoritet Kontraktues i specifikuar në Aneksin 7 do të emerojë një përfaqësues si pikë koordinimi ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Furnizuesit i cili do të jetë në dispozicion çdoherë që kërkohej dhe do të ketë autoritetin për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhe çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës
Ndihma lidhur me rregulloret vendore	6	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit	7.1	Kërkohej nga Furnizuesi që të marrë nënshkrimet e pranimit të karburanteve / të leshojë kuponin e karburantit dhe/apo fletën e të dhenave nga i gjithë personeli i autorizuar të cilët marrin Karburantet për përdorim në automjete, gjeneratore, nxehe, etj. Nevojiten të dhënat në vijim: • Data dhe koha e leshimit • Emri i entitetit, departamentit, seksionit, njësisë pranuese

		• Emri - mbiemri dhe numri i identifikimit të individit që pranohet furnizimin • Lloji i karburantit të marr • Detajet e automjeteve, duke përfshirë numrin e automjetit, tipin e automjetit dhe rrugë matës të automjeteve ose • Barkodin e gjeneratorit , numrin serik dhe lexuesin e "oreve të punës" (kurdo që është i pajisur) ose • Në rastin e karburantit në Konteniere, destinacionin seku është duke u dërguar dhe numrin e autorizimit • Sasine (në litra) të karburantit. Furnizuesi, në baza 6 (gjashtë) muaj, do të raportojë me shkrim, tek Agjencia Qendrore e Prokurimit, lidhur me sasitë e karburanteve të dorëzuara tek secili autoritet Kontraktues. Një fletë e verçante duhet të përgatitet për secilin Autoritet Kontraktues. Raporti duhet të paraqes: • Sasine e karburanteve të dorëzuara gjatë 6 muajve; • Llojin e karburanteve; • Datën e faturave, numrin e faturave dhe vlerën e faturave • Datën e pagesës së faturave Agjencia Qendrore e Prokurimit do të hartojë një model të Raportit dhe do ta dërgojë të Furnizuesi jo më vonë se 20 ditë nga nënshkrimi i kontratës. Obligohet furnizuesi që ta shfrytëzojë këtë model të Raportit gjatë raportimit të AQP-jë.	
Obligimet përgjithshme Furnizuesit	e te	7.2	Autoriteti Kontraktues në nenin 7.2 i referohet cilitdo autoritet kontraktues të identifikuar në Aneksin 7.
Obligimet përgjithshme Furnizuesit	e te	7.4 dhe 7.5	Autoriteti Kontraktues në nenin 7.4 dhe 7.5 i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit. Kontraktuesi do të emërojë një përfaqësues, i cili do të veprojë si pikë kontaktuese e Furnizuesit për të gjitha çështjet që lidhen me kontratën. Ky përfaqësues apo zëvendësi i tij duhet të jetë në dispozicion çdo herë që kërkohej dhe do të ketë autoritetin e duhur për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës. Në rast të caktuar nëse për shkak të skadimit të validitetit të licencave të shitjes me pakicë të pikave të karburantit të nënkontraktuar, në rast të shkeputjes së marrëveshjeve të nënkontraktimit me nënkontraktuar apo në rast të hapjes së ndonjë pike të re të karburantit që ka në pronësi apo të marrur me qira, Furnizuesi ka të drejtën që ta nderojë pikën e nënkontraktimit me paralajmërim në afat prej 10 ditëve të Agjencisë Qendrore të Prokurimit dhe të gjitha Autoritetet Kontraktuese që shfrytëzojnë kontratën të specifikuar në Aneksin nr. 7.

Siguria e ekzekutimit	8.1	Furnizuesi, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do të dorëzojë tek Agjencia Qendrore e Prokurimit një sigurim për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% të vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 37 muajsh. Shuma e sigurisë së ekzekutimit është: 1,134.822,89 (Një milion e njëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e njëzetë e dy euro e tetëdhjetë e nëntë cent) në kohëzgjatje prej 37 muaj prej datës së nënshkrimit të kontratës.
Sigurimi	9.1	N/A
Periudha e ekzekutimit detyrave	12	Kurdo që ndonjëri nga Autoritetet Kontraktuese pale të kësaj kontrate dëshirojnë që të blejnë Naftë për gjeneratorë apo naftë për ngrohje sipas kësaj kontrate, duhet që të dërgojnë një "Flete Porosi" tek Furnizuesi. Nuk nevojitet "flete porosi" për furnizim me karburante për vetura.
Zgjatja e periudhës së ekzekutimit	13	Autoriteti Kontraktues në nenin 7.2 i referohet cilitdo autoritet kontraktues të identifikuar në Aneksin 7.
Vonesat e ekzekutimit	14	Autoriteti Kontraktues në nenin 7.2 i referohet cilitdo autoritet kontraktues të identifikuar në Aneksin 7.
Suspendimi	15	Autoriteti Kontraktues në nenin 7.2 i referohet cilitdo autoritet kontraktues të identifikuar në Aneksin 7.
Cilësia e furnizimeve	16.1	Autoritetet Kontraktuese të cilat janë të identifikuar në Aneksin 7 kanë të drejtë të refuzojnë çdo dergesë të karburantit i cili deshton në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësive të percaktuara në këtë specifikim teknik, duke njoftuar me shkrim Furnizuesin dhe AQP-ne,
Cilësia e furnizimeve	16.2	Për furnizimin me karburante Autoritetet Kontraktuese të specifikuara në Aneksin 7 nuk lëshojnë ndonjë pranim të përkohshëm. Pasi që të shkarkohen karburantet në rezervuarët e gjeneratorëve të Autoriteteve Kontraktuese, në automjete etj dhe nënshkruhet fletëpranimi nga një person i autorizuar i Autoritetit Kontraktues malli do të konsiderohet si i pranuar përkohësisht.
Inspektimi dhe testimi	17.2	Furnizuesi duhet të kryejë inspektimin e kontrollit të cilësisë së produkteve të ofruara dhe do të dorëzojë ato tek AK-ese të specifikuara në Aneksin 7 në përputhje me procedurat, standardet dhe frekuencat e rekomanduara të cilat zakonisht zbatohen në industrinë e naftës. Kurdo që behet dergesa e karburanteve tek AK secila cistern duhet të jetë e shoqëruar me një Certifikatë të Kualitetit tëleshuar nga një Institucion i Pavarur për Certifikim të cilësive. Autoritetet Kontraktuese të specifikuara në Aneksin 7 rezervojnë të drejtën që kohe pas kohe të testojnë produktet të cilat i furnizon Furnizuesi. Shpenzimet që do të shfaqen gjatë inspektimit të karburanteve do të kompensohen nga Furnizuesi.
Pagesat	18	Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga secili Autoritet Kontraktues i specifikuar në Aneksin 7 për karburantet në baza mujore (ex post) sipas konsumit aktual. Nuk ka pagesa paraprake. Kërkesat për pagesë do të bëhet vetëm për karburantet në baza mujore (ex post) sipas konsumit aktual dhe lëshimit të faturave.

		Brenda 10 (dhjetë) ditë pune pas përfundimit të çdo muaji, Furnizuesi duhet të dorëzojë tek secili AK i specifikuar e Aneksin 7 një faturë origjinale dhe një kopje për karburantet të cilat janë shpërndarë dhe /ose dorëzuar gjatë muajit të tillë. Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të deklarohen në Euro. Çdo faturë duhet të përmbajë të informacionin e nevojshme. Rishikimi i Çmimit: Çmimet e karburanteve të specifikuar në Listën e çmimeve do të përditësohet duke marrë parasysh elementet e mëposhtme: Referoju pjesës C, Seksioni II, Lista e Çmimeve dhe Aneksi nr. 10 - Tabela per llogaritjen e çmimit kushtues te karburanteve. Agjencia Qendrore e Prokurimit ka qasje ne berze dhe bene kalkulimin e çmimit ne baza mujore duke u bazuar ne Aneksin nr. 10 Tabela per llogaritjen e çmimit kushtues te karburanteve. Autoriteti Kontraktues-Agjencia Qendrore e Prokurimit me se largu deri me daten pese (5) te muajt vijues dergon te Furnizuesi kalkulimin e çmimeve per muajin paraprak. Obligohet Furnizuesi qe me se largu deri me daten dhjete (10) te muajt vijues ti dergoje te gjitha faturat per shpenzimet e karburanteve per muajin paraprak te Autoritetet Kontraktuese qe shfrytezojne kontraten te specifikuar ne Aneksin 7. Agjencia Qendrore e Prokurimit, vendimin e formimit te çmimeve te karburanteve per çdo muaj do ta publikoj ne ueb faqen e AQP-se. Kete vendim te formimit te çmimeve te publikuar ne ueb faqen e AQP-se kane te drejte ta shfrytezojne vetem Furnizuesi sipas kushteve te kesaj kontrate dhe Autoritetet Kontraktuese qe jane shfrytezues te kesaj kontrate kornize dhe jane te specifikuar ne Aneksin nr. 7. Nuk lejohet nga asnje Autoritet Kontraktues tjetër ne Kosove qe ta perdorin kete Vendim te formimit te çmimeve.
Vonesa ne pagesa	18.5	Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që të ndërpresë furnizimet e mëtejme për Autoritetin kontraktues përkatës, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues përkatës dhe Agjencinë Qendrore të Prokurimit.
Dorëzimi	19.3	Rreziku i humbjes apa demtimit, te karburantit nga ndonje shkak do te jete mbi Furnizuesin dhe do te perballohet nga Furnizuesi deri ne kohen kur karburanti te dorezohet ne pronesi te AK apa ne rezervuaret e automjeteve dhe gjeneratoreve te autorizuar te AK. Paketimin dhe shënimin: Paketimi dhe shënimin duhet të jetë në përputhje me procedurat dhe standardet e aplikuara në industrinë e naftës. Vendndodhja e pikave te karburantit: Vendndodhja e pikave te karburantit është e specifikuar ne Aneksin 9. Nëse Furnizuesi, për çfarëdo arsye ndërron lokacionet e specifikuar në Aneksin 9, Furnizuesi është i detyruar të njoftojë, me shkrim, Agjencinë Qendrore të Prokurimit në lidhje me lokacionin e ri. Agjencia Qendrore e Prokurimit do te njoftoj menjëherë te gjitha Autoritetet Kontraktues pale te kontratës kornize për lokacionin e ri. Ky ndryshim do të hyjë në fuqi 24 orë pas njoftimit ose ndonjë datë tjetër siç është specifikuar në njoftimin e tillë.

		Largesia maksimale e pikave te karburantit qe Operatori Ekonomik ka ne pronesi apa te marruar me qira munde te jetederi ne 10 km nga qendra e qytetit. Per pikat e karburantit qenenkontraktohen, largesia maksimale munde te jete deri ne 5 Km nga qendrat e qyteteve. Çdo Autoritetet Kontraktuese qe shfrytezojne kontraten te specifikuar ne Aneksin 7, nese gjate realizimit te kontrates Institucionet e tyre zhvillojne aktivitet ne Lokacione tjera qe nuk jane te cekura ne Aneksin 9 kane te drejten te kerkojne nga Furnizuesi qe te kete ne pronesi apo te nenkontrakttoj pika te shitjes se karburantit ne Lokacione tjera. Kerkesa per hapjen e pikave te reja te shitjes se karburanteve duhet te behet me shkrim dhe i dergohet Furnizuesit dhe nje kopje e Kerkeses i dergohet Agjencise Qendrore te Prokurimit. Obligohet Furnizuesi qe ne afat prej 10 diteve te kete pi ken e shitjes se karburanteve ne Lokacionin e specifikuar ne kerkesen e Autoritetit Kontraktues Liferimi i karburanteve në pikat e karburanteve: Ështëpërgjegjësi e Furnizuesit për të siguruar që çdo kërkesë për furnizim me karburante është e ligjshme vetëm nëse është e autorizuar nga ndonjëri prej Autoriteteve Kontraktuese specifikuaranë Aneksin 7. Autorizimi i tillë konsiderohet se është dhënë vetëm nëse numri i regjistrimitteveturës është në listën e automjeteve të paraqitura nga Autoriteti përkatës kontraktues tek Furnizuesi. Një listë e tillë mund të përditësohet kohepas kohe nga cilido AK. Një listë e tillë do të jetë efektiv vetëm pas 24 orësh pas datës dhe kohësse marrjes së një liste të tillë nga ana e Furnizuesit. Furnizuesi pajtohet qe të dorëzojë tek secili AK, pale i kësaj kontrate kornize, emrin dhe kontakt detajet e personit përgjegjës për shpërndarjen e listës së tillë dhe të gjitha përmirësimet eventuale tek te gjitha pikat e karburantit, të përcaktuara në Aneksin 9. Nëse ka ndonjë kërkesë për furnizim me karburante nga ndonjë anëtar i stafit të Autoriteteve Kontraktuese te përcaktuar ne Aneksin 7 për ndonjë automjet, në ndonjë nga pikat e karburantit te furnizuesit, dhe kjo kërkesë refuzohet nga ndonjëri prej punëtorëve te Furnizuesit apo Nën-kontraktuesve, atëherë, anëtari i tillë menjëherë do të verifikojë me personin e lartcekur përgjegjës me telefon, faks ose e-mail, nëse vetura është e konsideruar si Mjet Motorik. Furnizuesi do të sigurojë që të gjithë punonjësit e tij, duke përfshirë edhe nënkontraktorët e tij, janë të njoftuar mirë me këtë procedurë, ashtuqë te evitohet çfarëdo keqkomunikimi apo keqkuptimi sa më mirë që është e mundshme. Në rast se ndonjë punëtor i Furnizuesit ose Nën-kontraktuesit refuzon që të ofrojë karburantet e mbuluara me këtë kontratë ose refuzon të bëjë procesin e mësipërm te verifikimit ose vetura shkon në pikën e karburantit dhe nuk ka karburant, anëtari i stafit të Autoritetit Kontraktues do të ketë të drejtë të bëjë një Raport të Dështimit të Liferimit te Karburantit, i cili pas verifikimit, do t'i japë të drejt Autoritetit përkatës Kontraktues që për çdo incident të tillë të mbajë/zbresë një shumë prej 100 Euro nga fatura e ardhshme për Furnizuesin. Lokacionet e Autoriteteve Kontraktuese Vendndodhjet e Gjeneratorëve, rezervarëve te naftës për nxehje janë te specifikuar në Aneks 9. AK rezervon të drejtën të shtojë gjenerator te tjerë apo lokacione te tjera për furnizim me karburante në çfarëdo kohe gjatë periudhës së Kontratës. OE do të njoftohet paraprakisht me shkrim për lokacionin e ri minimum 48 orë para kërkesës fillestare. Njëjtë, AK rezervon të drejtën të largoje nga lista disa gjenerator ose rezervuar te naftës për ngrohje për te cilët nuk kërkohet me furnizim.
--	--	--

		Dorëzimi i karburantit: Afati kohor për dorëzimin e karburantit në pikat e shpërndarjes së Autoriteteve Kontraktuese është 3 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e cilitdo Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Aneksin 7. AK bie dakord për lëshimin e urdhër blerjeve për sasi që nuk janë më pak se 50% të kapacitetit të magazinimit të rezervuarit për të cilat është bërë aplikimipor në asnjë rast jo më pak se 500 litra. Anulimi i porosisë së dorëzimit: Autoriteti Kontraktues mund të ndryshojë apo anulojë urdhrin për furnizim të karburanteve me një njoftim paraprak me shkrim më së voni 24 orë para kohës së liferimit të porositur.	
Verifikimi operimeve	i	20	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet cilitdo autoritet kontraktues të identifikuar në Aneksin 7.
Pranimi përkohshëm	i	21	Për furnizim me karburante Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 nuk lëshojnë ndonjë pranim të përkohshëm.
Obligimet garancionit	e	22.1	Furnizuesi garanton që furnizimet janë në pajtueshmëri të plotë me specifikimet e kërkuara. Furnizuesi garanton që furnizimet nuk kanë asnjë defekt sasior apo cilësor dhe se në rast të konstatimit të këtyre defekteve, Furnizuesi do të bëjë përpjekje maksimale për zëvendësimin e menjëhershëm të karburanteve të liferuara. Në rast të defekteve apo mosfunksionimit normal të pajisjeve apo impianteve të Autoritetit Kontraktues, të shkaktuara nga cilësia e dobët e furnizimeve (karburanteve), Furnizuesi është i obliguar që të bëjë kompensimin total të dëmeve të shkaktuara nga cilësia jo adekuate e furnizimeve. Sidoqoftë, Furnizuesi duhet të sigurojë se të gjithë njehsorët nëpër pikat e karburantit dhe auto-cisternat (vetanake apo të nën-kontraktuar) janë në pajtueshmëri të plotë me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë. Kjo nënkupton, se të gjithë njehsorët e lartcekur duhet të kenë kaluar testin e saktësisë.
		22.5	N/A
Shërbimet pas shitjes		23.1	N/A
Pranimi përfundimtar		25	N/A
Ndërprerja Kontratës Autoriteti kontraktues	e nga	26	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Ndërprerja Kontratës Furnizuesi	e nga	27	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet cilitdo autoritet kontraktues të identifikuar në Aneksin 7.

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	Cdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindingjate ekzekutimit se kësaj kontrate dhe se është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, përgjegjes për zgjidhjen e tyre dote janë personat përgjegjes të Autoritetit Kontraktues - AQP-se, të zyrtarëve përgjegjes të Autoriteteve Kontraktuese qeshfrytezojnë kontratën dhe personat përgjegjes të Furnizuesit.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, në pajtim me ligjin e Kosovës. ose b) Kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunalit Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.

Pjesa II. LISTA E ÇMIMEVE

Lot 1

NR. I ARTIK ULLIT	NJESIA MATESE	PERSHKRIMI	SASIA E PERAFERT PER 36 MUAJ	PREMIUMI PER NJE LITER NE EURO	TOTALI I VLERES SE PREMIUMIT
A	B	C	D	E	F= D x E
1	LITER	DIESEL PER VETURA DHE MUJTE TJERA LEVIZESE 10PPM	9,705,000.00	0.093	902 565.00
2	LITER	BENZIN PER VETURA / GJENERATOR 10PPM	43,500.00	0.093	4 045.50
TOTALI I PERGJITHSHEM I VLERES SE PREMIUMIT PER SASITE E PERAFERTA PER 36 MUAJ					906 610.50 €

~~MIBETROL~~

Aneks 9 LOKACIONET E PIKAVE TE KARBURANTIT


OBLIGATIVE QE TE PLOTESOHET NGA OPERATORET EKONOMIK PER LOT-IN QE OFERTONI

	Qyteti	Emri dhe adresa e Pompes se Benzines gjate ekzekutimit te kontrates	Pompa e benzines ne pronesi, me qira apo pritet qe te nënkontraktohet (sheno ne pronesi – me qira apo te nënkontraktohet)
1	Prishtine	HIB Petrol1, Shkabaj	HIB Petrol- Pronesi
2	Peje	HIB Petrol1, Rr. Zahir Pajaziti	HIB Petrol- Pronesi
3	Gjakove	NT Stella 1, Fehmi Agani	NT Stella-Nenkontraktim
4	Kline	Benita Company1, Gremnik	Benita Company-Nenkontraktim
5	Gjilan	HIB Petrol1, Shillove	HIB Petrol- Pronesi
6	Kamenice	Borovci Oil1, Kamenice	Borovci Oil-Nenkontraktim
7	Viti	Veda 2 Petrol1, 4 korriku	Veda 2 Petrol-Nenkontraktim
8	Klllokot	Tina Petrol1, Klllokot	Tina Petrol-Nenkontraktim
9	Novohërdë	HIB Petrol1, Shillove	HIB Petrol- Pronesi
10	Mitrovce	HIB Petrol1, Magj. Mitrovce-Prishtine	HIB Petrol- Pronesi
11	Prizren	HIB Petrol1, Zona Industriale	HIB Petrol- Pronesi
12	Ferizaj	HIB Petrol1, Fshati vllat	HIB Petrol- Pronesi
13	Graçanicë	HIB Petrol1, Peroc	HIB Petrol- Pronesi
14	Hani i Elezit	Alba Oil1, Hani i Elezit	Alba Oil-Nenkontraktim
15	Podujeve	HIB Petrol1, Llapashtice e poshtme	HIB Petrol- Pronesi
16	Lipjan	HIB Petrol1, Magj. Ferizaj-Prishtine	HIB Petrol- Pronesi
17	Glllogoc	HIB Petrol1, Kamaran	HIB Petrol- Pronesi
18	Shtërpce	Liria Petrol1, Drajko	Liria Petrol- Nenkontraktim

Formatted Table

Formatted Table

DOSJA E TENDERIT PËR KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË ME NJË OPERATOR



 HIB PETROLI

Numri i Prokurimit: AQP/18/002/111 – Titulli:Furnizim me Karburante

19	Kaçanik	Bubeari Komercet1, Kacanik	Bubeari Komerce-Nenkontraktim
20	Suharekë	Flamuri 1, Suhareke	Flamuri -Nenkontraktim
21	Malisheve	Pajtimi Petrol1, Gjerhj Kastrioti Skenderbe	Pajtimi Petrol-Nenkontraktim
22	Rahovec	Jaha SHPK1, UÇK	Jaha SHPK-Nenkontraktim
23	Dragash	Qendra Petrol1, Pllav	Qendra Petrol-Nenkontraktim
24	Deçan	M&M Petrol1, Deqan	M&M Petrol-Nenkontraktim
25	Istog	Ibos Petrol1, Skenderbeu Istog	Ibos Petrol-Nenkontraktim
26	Skenderaj	Alfa Trade1, Kline e Ulet	Alfa Trade-Nenkontraktim
27	Vushtri	Elan Petrol1, Qender Vushtri	Elan Petrol-Nenkontraktim
28	Leposaviq	HIB Petrol1, Shupkovc	HIB Petrol- Pronesi
29	Zubin Potok	HIB Petrol1, Shupkovc	HIB Petrol- Pronesi
30	Fushë Kosovë	HIB Petrol1, Bresje	HIB Petrol- Pronesi
31	Junik	Molika Gas1, Junik	Molika Gas-Nenkontraktim
32	Mamushë	Adem Petrol1, Mamushe	Adem Petrol-Nenkontraktim
33	Obiliq	Inter As Petrol1, Obiliq	Inter As Petrol-Nenkontraktim
34	Partesh	Tina Petrol1, Kllakot	Tina Petrol-Nenkontraktim
35	Ranilluk	Albina 1, Ranilluk	Albina -Nenkontraktim
36	Shtime	Ibrahimi Petrol1, Shtime	Ibrahimi Petrol-Nenkontraktim
37	Zveqan	HIB Petrol1, Shupkovc	HIB Petrol- Pronesi

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Vula _____

1. » Operatori Ekonomik (OE) duhet të ketë së paku një pikë karburanti në qytetet e përmendura më lartë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi të pronësisë apo të qirëgjatë të pompës së benzinës dhe së bashku me ofertë duhet të dorëzojë licencën e shijes me pakicë.
2. Nëse Operatori Ekonomik i shpërblyer me kontratë nuk posedon së paku një pikë karburanti në qytetet e specifikuar më lartë, OE mund të nënkontraktojë piken e

DOSJA E TENDERIT PËR KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË ME NJË OPERATOR

Numri i Prokurimit: AQP/18/002/111 – Titulli: Furnizim me Karburante

karburantit. Licenca e shitjes me pakicë për piken e karburantit të nënkontraktuar duhet të dorëzohet tek Autoriteti Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit para nënshkrimit të kontratës. Përjashtim bëjnë pikat e karburantit në Leposaviq dhe Zubin Potok ku licencat dhe marrëveshjet e nënkontraktimit për këto pika dorëzohen te AK pasi që këto pika të karburantit të pajisen me Licenca të shitjes me pakicë nga MTI-ja.

3. Operatori Ekonomik, i propozuar për shpërbllim të kontratës, në qoftë se brenda 7 ditëve nga njoftimi nuk i dorëzon dokumentet e kërkuara sipas pikës 2, i japë të drejtë Autoritetit Kontraktues për të konsideruar ofertën e tillë si ofertë të pa përgjegjshme, të konfiskoje garancionin e sigurisë së ofertes dhe të vazhdojë me dhënien e kontratës tek OE i dytë i renditur.
4. Largesia maksimale e pikave të karburantit që Operatori Ekonomik ka në pronësi apo të marruar me qira munde të jete deri në 10 km nga qendra e qytetit. Për pikat e karburantit që nënkontraktohen, largesia maksimale munde të jete deri në 5 Km nga qendra e qytetit. Novobërdë pika maksimale 25 km ndërsa për stacionet në regjionin e mitrovicës (Zubin Potok, zveqan dhe Leposaviq 40 km).
5. Pikat e karburanteve do të jete të hapura hapen 7 ditë / 24 ore.
6. Çdo Autoritet Kontraktues që shfrytëzojnë kontratën të specifikuar në Aneksin 7, nëse gjatë realizimit të kontratës Institucionet e tyre zhvillojnë aktivitet në Lokacione tjera që nuk janë të cekura në Aneksin 9 kanë të drejtën të kërkojnë nga Furnizuesi që të kete në pronësi apo të nënkontraktoj pika të shitjes së karburantit në Lokacione tjera. Kërkesa për hapjen e pikave të reja të shitjes së karburanteve duhet të behet me shkrim dhe i dërgohet Furnizuesit dhe një kopje e Kërkesës i dërgohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit. Obligohet Furnizuesi që në afat prej 10 diteve të kete pikën e shitjes së karburanteve në Lokacionin e specifikuar në kërkesën e Autoritetit Kontraktues
7. \.
8. Çdo Autoritet Kontraktues i specifikuar në Aneksin 7, nëse gjatë realizimit të kontratës Institucionet e tyre zhvillojnë aktivitet në Lokacione tjera që nuk janë të cekura në Aneksin 9 kanë të drejtën të kërkojnë nga Furnizuesi që të kete në pronësi apo të nënkontraktoj pika të shitjes së karburantit në Lokacione tjera. Kërkesa për hapjen e pikave të reja të shitjes së karburanteve duhet të behet me shkrim dhe i dërgohet Furnizuesit dhe një kopje e Kërkesës i dërgohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit. Obligohet Furnizuesi që në afat prej 10 diteve të kete pikën e shitjes së karburanteve në Lokacionin e specifikuar në kërkesën e Autoritetit Kontraktues

REPUBLIKË E KOSOVËS
»HIB PETROL«
FURNIZIM
KONTRAKTIMET

DOSJA E TENDERIT PËR KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË ME NJË OPERATOR





HIB PETROL

Për: Agjencia Qendrore e Prokurimit
Titulli: Furnizim me Karburante
Tema: Specifikimet teknike te detyrueshme

Me rastin e konkurimit tonë në tenderin për "Furnizim me Karburante", për nevojat e "Agjencia Qendrore e Prokurimit". Kompania HIB Petrol shpk deklaron se:

Mallrat e ofruara përputhen me ato të përmendura ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit.

Nenshkrimi	
Emri	Fatbardh Xhaferi
Pozicioni	Menaxher Gjeneral
Data	05/12/2018
Vula	

PARATHENIE

Formatted: Space After: 0 pt, Tab stops: 3.25", Centered + Not at 1.11"

Sipas nenit 94 te Ligjit te Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin. No. 05/L-092, ne kuadër te Ministrisë se Financave të Republikës së Kosovës është themeluar Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) .

AQP sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, është përgjegjëse për:

- ✓ Zhvillimin e prokurimeve të përbashkëta për Autoritete Kontraktuese;
- ✓ Me kërkesën e Autoriteteve Kontraktuese, kryen aktivitetet e prokurimit ne emër te tyre; dhe
- ✓ Me kërkesën e Autoriteteve Kontraktuese, ndihmon në kryerjen e aktiviteve të prokurimit.

Ne baze të Udhëzimit Administrativ– Nr.06/2018 për implementimin e procedurave qendrore të prokurimit publik, miratuar në mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. AQP është autorizuar që të filloj me procedurat qendrore për Furnizim me Karburante në emër të Autoriteteve kontraktuese (shih listën e autoriteteve kontraktuese Aneksin nr. 7)

Autoriteti Kontraktues (Agjencia Qendrore e Prokurimit) është duke identifikuar furnizuesit që do të kenë kapacitetin për të furnizuar me Karburante per Autoritetet Kontraktuese të identifikuar në Aneksin 7.

Formatted: Normal, Tab stops: 1.11", Left

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Autoriteti Kontraktues (Agjencia Qendrore e Prokurimit) është duke identifikuar furnizuesit që do të kenë kapacitetin për të furnizuar me karburante Autoritetet Kontraktuese të identifikuar në Aneksin 7. Furnizuesit do të jenë përgjegjës për menaxhimin e plotë të furnizimit me karburante për Autoritetet Kontraktuesetë identifikuar në Aneksin 7, duke përfshirë:

- a) importimin e karburanteve;
- b) shpërndarjen e karburanteve në të gjithë territorin e Kosovës;
- c) shkarkimin e karburantit ne automjete, gjeneratorë, rezervarë te nxehtjes.

Karburante do të thotë naftë dhe benzinë.

Sasia e përafërt e karburanteve:

LOT 1

Nr.	Pershkrimi	Njesia matese	Sasia e perafert per 36 muaj
1	Diesel per vetura, gjenerator, nxehte dhe mjete tjera levizese 10 ppm	liter	9,705,000.00
2	Benzin per vetura 10 ppm (95 dhe 98)	liter	43,500.00

DOSJA E TENDERIT PËR KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË ME NJË OPERATOR

LOT 2

Nr.	Pershkrimi	Njesia matese	Sasia e perafert per 36 muaj
1	Diesel per vetura, gjenerator, nxehje dhe mjete tjera levizese 10 ppm	liter	5,843,400.00
2	Benzin per vetura 10 ppm (95 dhe 98)	liter	516,000.00

LOT 3

Nr.	Pershkrimi	Njesia matese	Sasia e perafert per 36 muaj
1	Diesel per vetura, gjenerator, nxehje dhe mjete tjera levizese 10 ppm	liter	4,567,100.00
2	Benzin per vetura 10 ppm (95 dhe 98)	liter	107,800.00

LOT 4

Nr.	Pershkrimi	Njesia matese	Sasia e perafert per 36 muaj
1	Diesel per vetura, gjenerator, nxehje dhe mjete tjera levizese 10 ppm	liter	2,141,300.00
2	Benzin per vetura 10 ppm (95 dhe 98)	liter	340,400.00

LOT 5

Nr.	Pershkrimi	Njesia matese	Sasia e perafert per 36 muaj
1	Diesel per vetura, gjenerator, nxehje dhe mjete tjera levizese 10 ppm	liter	6,913,000.00
2	Benzin per vetura 10 gje gjenerator ppm (95 dhe 98)	liter	11,000.00

OE duhet te posedoj (apo te nenkotratoj) se paku njeh pike te shitjes ne qytetet e specifikuar ne Aneksin 9 te LOT-it qe oferton.

DOSJA E TENDERIT PER KONTRATEN PUBLIKE KORNIZE ME NJE OPERATOR

Rreziku i humbjes apo dëmtimit, te karburantit nga ndonjë shkak do të jetë mbi Furnizuesin dhe do te përballohet nga Furnizuesi deri ne kohen kur karburantite dorëzohet në pronësi te AK apo në rezervuarët e automjeteve dhe gjeneratorëve të autorizuar te AK.

AK te cilat janë te identifikuar ne Aneksin 7 kane të drejtë të refuzojnë, duke njoftuar me shkrim Furnizuesin, çdo dërgesë të karburantit i cili dështon në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësisë të përcaktuara në këtë specifikim teknik.

Agjencia Qendrore e Prokurimit pas nënshkrimit te kontratës do te shpërndaje nga një kopje te nënshkruar te kontratës tek secili Autoritet Kontraktues i identifikuar ne Aneksin 7. Një kopje e kontratës se nënshkruar do te publikohet ne webfaqen e AQP-se.

Secili Autoritet Kontraktues i specifikuar ne Aneksin 7, brenda 7 (shtate) ditëve, pas pranimit te kontratës se nënshkruar nga AQP, është i obliguar qe te dorëzoj tek Operatori Ekonomik një liste te veturave (me numra te regjistrimit) te autorizuar për furnizim me karburante ne pompat e Operatorit Ekonomik. Një liste e tille mund te freskohet kohe pas kohe nga ana e AK-ese. Një listë e tillë do të jetë efektive vetëm pas 24 orësh pas datës dhe kohësse marrjes së një liste të tillë nga ana e Operatorit Ekonomik.

Disa Autoritete Kontraktuese te cilat janë te identifikuar ne Aneksin 7 kane kontratat e tyre ekzistuese. Këto kontrata nuk do të ndërpritën, por do të vazhdojnë deri në datën e skadimit. Dy jave para skadimit të kontratës autoriteti përkatës kontraktues do të njoftoj me shkrim Agjencionin e Prokurimit Qendror dhe Operatorin ekonomik lidhur me datën e skadimit e te kontratës dhe datën e fillimit te shfrytëzimit te kontratës kornizë. Autoriteti përkatës Kontraktues gjithashtu do te dorëzoj tek Operatori Ekonomik një liste te veturave (me numra te regjistrimit) te autorizuar për furnizim ne pompat e benzinës se Operatorit Ekonomik.

OE, në koston dhe shpenzimet e tij, do të instaloj matës (metra)ne automjetet e karburantit ne mënyre qe të regjistroj me saktësi sasinë e karburantit te dorëzuar.Këta matës duhet të duhet të kalibrohen dhe te jenë në përputhje me ligjet e aplikueshme dhe standardet e industrisë. Periodikisht, AK-ese te specifikuar ne Aneksin 7 ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar mund të inspektojnë dhe testojnë matësit e tille. Do të kërkohet nga OE të rikalibrojë matësit e tij për të eliminuar ndonjë mospërputhje në mes leximeveve njehsorëve te OE dhe rezultateve të inspektimit te AK-ese.

Kërkohet nga OE qe të marrë nënshkrimet e pranimit te karburanteve / te lëshojë kuponin e karburantit dhe/apo fletën e te dhënave nga i gjithë personeli autorizuar të cilët marrin karburantet për përdorim në automjete, gjeneratorë. Nevojiten të dhënat në vijim:

- Data dhe koha e lëshimit
- Emri i entitetit, departamentit, seksionit, njësisë pranuese
- Emri dhe numri i identifikimit të individit qe pranon shërbimin
- Lloji i karburantit te marr
- Detajet e automjeteve, duke përfshirë numrin e automjetit, tipin e automjetit dhe rrugëmatësin e automjeteve ose
- Barkodin e gjeneratorit , numrin serik dhe lexuesin e "orëve te punës" (kurdo qe është i pajisur) ose
- Në rastin e karburantit ne Kontenierë, destinacioninse ku është duke u dërguar dhe numrin e autorizimit
- Sasinë (në litra) te karburantit.

Furnizuesi do të emërojë një përfaqësues, i cili do të veprojë si pikë kontaktuese e Furnizuesit për të gjitha çështjet që lidhen me kontratën. Ky përfaqësues apo zëvendësi i tij duhet të jetë ne dispozicion 24/7 dhe do të ketë autoritetin e duhur për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

DOSJA E TENDERIT PËR KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË ME NJË OPERATOR

Numri i Prokurimit: AQP/18/002/111 – Titulli: Furnizim me Karburante

Çdo AK i specifikuar ne Aneksin 7 do të emërojë një përfaqësues si pikë fokale ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe OE i cili do të jetë ne dispozicion 24/7 dhe do të ketë autoritetin për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

Kërkohet nga OE që të dorëzojë karburantet dhe të mbush gjeneratorët dhe rezervarët e naftës për ngrohje të listuar në Aneksin 87. Përveç listës së specifikuar, AK-ese të specifikuara ne Aneksin 7 rezervojnë të drejtën të shtojnë gjenerator të tjerë apo lokacione të tjera për furnizim me karburante në çfarëdo kohe gjatë periudhës së Kontratës. OE do të njoftohet paraprakisht me shkrim për lokacionin e ri minimum 48 orë para kërkesës fillestare. Njëjtë, AK-esete specifikuara ne Aneksin 7 rezervojnë të drejtën të largojnë nga lista disa gjenerator ose rezervuarë naftës për ngrohje për të cilët nuk kërkohet me furnizim.

Urdher blerjet e lëshuar nga cilido AK i specifikuar në Aneksin7 për furnizim me naftë për ngrohje apo naftë për gjeneratorë nuk mund të lëshohet për më pak se 500 litra.

Specifikimi teknik për Diesel për vetura, gjenerator, nxehtë dhe mjete tjera levizese 10 ppm dhe Benzin sipas (UDHËZIM ADMINISTRATIV (MTI) Nr. 01 /2017 PËR CILËSINË E KARBURANTEVE TË LËNGËTA TË NAFTËS) ky udhëzim mundet të shkarkohet ne linkun : <https://mti.rks-gov.net/desk/inc/media/EDB342B8-7748-4E4A-861E-9B1017D7FF9A.pdf>

Cdo ndryshim i ardhshme i cilesise se karburanteve me ndonje Udhëzim nga Ministria e Tregtise dhe Industrise apo ndonje Institucion qe autorizohet me ligj qe ta beje kete, do te jete obligues per furnizuesin gjate realizimit te kontrates.

Ankesi 7 LISTA E AUTORITETEVE KONTRAKTUESE/NJESIVE KERRKUESE

Autoritetet Kontraktuese kane kontratat e tyre ekzistuese. Këto kontrata nuk do të ndërpriten, por do të vazhdojnë deri në datën e skadimit. Dy jave para skadimit të kontratës autoriteti përkatës kontraktues do të njoftoj me shkrim Agjencionin e Prokurimit Qendror dhe Operatorin ekonomik lidhur me datën e skadimit e te kontratës dhe datën e fillimit te shfrytëzimit te kontratës kornizë. Autoritetet Kontraktuese të cilët kanë të drejtë që të lëshojnë urdhër blerje sipas kushteve të kontratës kornizë janë si më poshtë:

Sasia e parashikuar për 3 vite ne litra

LOT I

Emri i Autoritetit Kontraktues	Njesia matese	Diesel per vetura, gjenerator, nxehje dhe mjete tjera levizese 10 ppm	Benzine vetura dhe gjenerator
Policia e Kosovës	Litra	9,705,000.00	43,500.00



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Financave - Министерство за Финансије - Ministry of Finance	
Nr. Prot.	98/19
Org. Prot.	
Org. Unit	AQP
Nr. i Fajdes	1/2
Date	16/07/2019

Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance Qeveria

**AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
CENTRALNA AGENCIA NABAVKE
CENTRAL PROCUREMENT AGENCY**

AMANDAMENT NR.1

Për kontratën publike kornize **"Furnizim me karburante (benzinë dizell) LOT 1"** me numër te prokurimit **UA/2016-18-3702-1-1-1** dhe numër te brendshëm te prokurimit **AQP-18-002-111** ; kontrata me numër : **08/19-DPQ**.

Agjencia Qendrore e Prokurimit, Ndërtesa e germis Zona A - kati V , Prishtinë (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëri anë; dhe
"HIB PETROL"SH.P.K .Magjistratja Prishtine Shkup, km 7 (ne vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër janë dakorduar si ne vijim:

Duke pasur parasysh se palët e përmendura më lartë kanë lidhur kontratë për aktivitetin e prokurimit **Furnizim me karburante (benzinë dizell) LOT 1"** me numër te prokurimit **UA/2016-18-3702-1-1-1** dhe numër te brendshëm te prokurimit **AQP-18-002-111**, me date **02.05.2019**;

Dispozita e mëposhtme e Kontratës **"Furnizim me karburante (benzinë dizell) LOT 1"** me numër te prokurimit **UA/2016-18-3702-1-1-1** dhe numër te brendshëm te prokurimit **AQP-18-002-111** ; kontrata me numër : **08/19-DPQ**, në këtë mënyrë zëvendësohet / plotësohet ne me se vijon:

Neni 1.4 Kontrata hyn ne fuqi me **12.07.2019** dhe përfundon me date **11.07.2022**. Sidoqoftë, ne rast se sasi të e parapara ne kontratën e udhëhequr përmes procedurës se negociuar pa publikim te njoftimit për kontrate skadojnë para datës se parapara, ne përputhje me nenin 56.10 te RUOPP, kontrata e udhëhequr përmes procedurës se negociuar pa publikim te njoftimit për kontrate do te ndërpritet automatikisht dhe Agjencia Qendrore e Prokurimit do te informoj me shkrim 7 dite me pare Furnizuesin, për hyrje ne fuqi te kësaj kontrate

Teksti i nenit të ri të ndryshuar

Neni 1.4 Kontrata hyn ne fuqi me **13.08.2019** dhe përfundon me date **12.08.2022**. Sidoqoftë, ne rast se sasi të e parapara ne kontratën e udhëhequr përmes procedurës se negociuar pa publikim te njoftimit për kontrate skadojnë para datës se parapara, ne përputhje me nenin 56.10 te RUOPP, kontrata e udhëhequr përmes procedurës se negociuar pa publikim te njoftimit për kontrate do te ndërpritet automatikisht dhe

Amandament kontrata:"Furnizim me karburante (benzinë dizell) LOT 1" me numër te prokurimit **UA/2016-18-3702-1-1-1** dhe numër te brendshëm te prokurimit **AQP-18-002-111**

Agjencia Qendrore e Prokurimit do te informoj me shkrim 7 dite me pare Furnizuesin, për hyrje ne fuqi te kësaj kontrate

Te gjitha dispozitat tjera mbesin te pandryshuara. Ky amendament do te jete pjese integrale e kontratës baze dhe hyn ne fuqi me nënshkrim nga te dy palët.

Ky amendament i kontratës është përgatitur ne gjuhen shqipe ne tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

PALËT KONTRAKTUESE:

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri: Mursel Racaj

Pozita: Zyrtar përgjegjës i prokurimit

Nënshkrimi:



Vula:

Data:



Për Furnizuesin:

Emri: *FATBARDH XHAFERI*

Pozita: *HEM AXHET I KONTRAKTIMUES*

Nënshkrimi:



Vula:

Data:

16.07.2019

